



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCAVE
DIREKCIJA JAVNIH SLUŽBI I VANREDNIH STANJA
DIRECTORATE OF PUBLIC SERVICES AND EMERGENCY

Tel: 038/200-46024
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

PLANI I PUNËS PËR VITIN - 2023

Sektori i Emergjencave

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e tjera. Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera.

Kuvendi i komunës nxjerr planin e mbrojtjes nga zjarri në mbështetje të Vlerësimit të rrezikut nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera elementare, rregulloret e kësaj drejtorie që janë në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga Ministria.

Prandaj, në kuadër të këtij ligji janë përcaktuar këto detyra:

- Zbulimi- identifikimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Merr masa për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe eliminimin e shkaktarëve që shkaktojnë fatkeqësi elementare.
- Vështrimi, lajmërimi, alarmimi dhe informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
- Organizimin e mbrojtjes dhe të gatishmërisë emergjente si dhe mënyrat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
- Shpëtimi dhe ndihma, evidentimi i pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë.
- Menaxhimi i ndihmave ndërkombëtare me rastin e fatkeqësive elementare dhe fatkeqësive tjera.
- Sanimin e gjendjes (rimëkëmbjen) pas fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
- Koordinimi i punëve dhe detyrave me organet e sigurisë në komunë, në bashkëpunim me KFOR-in, Kryqi i KUQ, PK-ës dhe FSK-ës.
- Në sferën e Emergjencave, bashkëpunimi me OJQ-të, Institucionet shëndetësore, lokalitetet urbane dhe rurale në raste të fatkeqësive elementare, zjarreve, vërshimeve, tërmeteve, si dhe në raste të tjera ku paraqitet nevoja.
- Vazhdimisht bënë vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë në territorin e komunës dhe njëkohësisht merr masa preventive për evidentimin dhe parandalimin e rrezikshmërisë.
- Përpilon raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.
- Bënë plotësimin e vlerësimit të rrezikshmërisë me elemente të reja plotësuese.
- Bënë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësitë tjera.

- Formon komisionin për vlerësimin e rreziqeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Rëndësi të veçantë, t'i kushtohet aftësimin të ekipeve vullnetare në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe ndihmës së parë mjekësore.
- Në rast nevoje, duhet të zbatohet plani për strehimin dhe evakuimin e qytetarëve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, duhet t'u ndihmohet familjeve të dëmtuara nga zjarri, vërshimet, erërat e forta, etj me një ndihmë emergjente.
- Vazhdimisht të bëhet inspektimi i të gjitha subjekteve në territorin e komunës së Ferizajt, në realizimin e punëve dhe detyrave nga lëmia për mbrojtje dhe shpëtim.
- Pranon , regjistron, dokumente, kërkesa dhe bënë arkivimin e dokumenteve sipas pranimin si dhe përgjigjet në kërkesat e palëve.
- Zbaton ligje dhe rregullore nga lëmia e emergjencave, lëshon vendime, jep këshilla juridike, përgatit procedura ligjore rreth masave ndëshkuese si dhe punë tjera në kompetenca ligjore.
- Në raste të jashtëzakonshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, i propozon kryetarit të komunës për shpalljen e gjendjes Emergjente, si dhe propozon urdhëresa dhe masa tjera administrative me qëllim të tejkalimit të situatës.
- Mbikëqyrë objektin e KK si dhe angazhon personelin për sigurimin e objektit.

Spektori i Emergjencës, duke u bazuar në nevojat elementare të emergjencave për komunën e Ferizajt, gjatë katastrofave të ndryshme që mund të ndodhin në vitin 2023 apo edhe më vonë, për t'u dal në ndihmë qytetarëve të komunës parasheh, këto projekte prioritete për vitin 2023:

- Pajisja me mjete të nevojshme për funksionalizimin e Njësisë së Zjarrfikës dhe Shpëtimit në pjesën jugore të qytetit.
- Pajisja e zyrës për Informim dhe alarmim me personel dhe aparaturë të nevojshme.
- Pajisjet për sistemin e alarmit.
- Vendosja dhe mirëmbajtja e hidrantëve në qytet dhe fshatra.
- Ndërtimi i një depoje për nevojat e drejtorisë.
- Vendosja e shkallëve emergjente në objektin e komunës së Ferizajt.
- Pastrimi dhe rregullimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve në të gjitha fshatrat e komunës së Ferizajt, ku ka lumenj dhe proçka.

- Rregullimin dhe aftësimin e strehimoreve në disa objekte të vjetra të rëndësisë së veçantë,
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit Dimëror.
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit Veror.

Njësia e menaxhimit të mbeturinave

Planifikohen të zhvillohen një numër i aktiviteteve të ndryshme siç janë: dita e pranverës, Dita e tokës po ashtu edhe shume aktivitete të tjera që ndërlidhen me mjedisin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Gjithashtu do vazhdojmë bashkëpunimin me organizatën e GIZI-it, CEDE, dhe MMPH-së për hartimin e disa planeve dhe rregulloreve që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave.

- Hartimi dhe miratimi i Planit të komunës për menaxhimin e mbeturinave-PKMM
- Plotësimi dhe rishikimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave
- Plotësimi dhe rishikimi i rregullores për përcaktimin e taksave dhe tarifave për mbeturinat e komunale.
- Eliminimi i deponime ilegale të mbeturinave e sidomos atyre të ngurta të identifikuara nga GIZ-i, si dhe zyrtarët e DSHPE-së.
- Investime në objekte, makineri e kontejnerë për menaxhim të mbeturinave.
- Vendosja, mirëmbajtja e kontejnerëve mbitorësorë në disa zona të qytetit e sidomos te disa banesa kolektive, si dhe furnizime me komposter shtëpiak
- Mirëmbajtja dhe rregullimi i varrezave të qytetit.
- Implementimi i planit të veprimit për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave.
- Krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre ekzistuese.
- Vendosja e aparateve për largimin e shpendëve.
- Rregullimi i sistemit të ujitjes në hapësirat e gjelbërta publike.
- Mirëmbajtja e hapësirave të institucioneve publike përfshirë sheshet, rrugët, varrezat e dëshmorëve, lapidarët etj.
- Mbjellja e luleve, drunjtëve dekorativ në qytet dhe fshatra.

Sektori i Shërbimeve Publike

Në kuadër të shërbimeve publike planifikohen të zhvillohen një numër i aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt do të prekin interesat e qytetarëve si: riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuareve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e vitit paraprak dhe gjendjes në teren planifikohen të realizohen këto punë dhe aktivitete.

- Planifikohen të mirëmbahen dhe të riparohen rreth 6300 m' të rrjetit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike në zonën e qytetit dhe fshatrave.
- Planifikohen të mirëmbahen dhe riparohen rreth 13500 m² të rrugëve me asfalt në zonën e qytetit dhe fshatrave.
- Planifikohen të mirëmbahen dhe riparohen rreth 7000 m² të trotuareve e sidomos në zonën e qytetit.
- Planifikohet edhe mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr, material jo koherentë 3500 m³ zhavorr 0.60-150mm-32000 m³, zhavorr 0.63mm-15000 m³, zhavorr 0.315mm-13000m³.
- Mirëmbajtja dhe funksionalizimi i fontanave në sheshin “Hyrë Emini” dhe fontana afër KEDS-it
- Gjithashtu do të bëhet edhe mirëmbajtja dhe riparimi i ujësjellësve nga kompania e kontraktuar nga Komuna.
- Rregullimi i tregut të gjelbër.
- Ne bashkëpunim me Asociacionin e komunave të Kosovës këtë vit do të përfundoj hartimi i planit të mobilitetit për komunën e Ferizajt i cili pastaj do të implementimet në teren.

Sektori i Komunikacionit Rrugor

Qëllimi i vendit të punës: Kujdesi ndaj zbatimit të ligjit, ofrimi i shërbimeve sa më të mira për qytetaret nga njësia e komunikacionit dhe transportit, krijimi i një ambienti të shëndoshë dhe ngritja e këtyre shërbimeve në një shkallë më cilësore do të jenë prioritet për vitin 2023. Bazuar në të drejtat dhe obligimet e drejtorisë nga kompetencat e saj të cilat dalin nga Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme, të cilat i përkasin fushë veprimtarisë së komunikacionit dhe transportit, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor, për vitin kalendarik 2023 ka planifikuar dhe hartuar këtë propozim të Planit të Punës.

1. Transporti rrugor

Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi në territorin e Komunës së Ferizajt është i organizuar në një nivel të kënaqshëm, ku nga 45 fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, 34 prej këtyre fshatrave janë të përfshira në transportin e rregullt urban-periferik, kurse 9 fshatra e shfrytëzojnë transportin ndër-urban, ndërsa 2 fshatra nuk janë të përfshira fare në transport publik.

Transporti taksi është i organizuar vetëm me automjete të udhëtarëve me numër të ulëseve 4+1 dhe duke filluar nga muaji janar kemi filluar me vazhdimin e lejeve për këtë veprimtari, për automjetet të cilat i plotësojnë kushtet për transport taksi.

Këtë vit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Infrastrukturës kemi planifikuar të bëhet rregullimi i disa vend-ndaljeve për autobus dhe vendqëndrime për pritje të udhëtarëve. Këto do të realizohen në disa fshatra ku ka hapësirë publike për rregullimin e tyre dhe prioritet do të jepet në ato fshatra ku autobusët operojnë më shpesh dhe në numër më të madh. Rregullimi i vendqëndrimeve për pritje të udhëtarëve dhe vend-ndaljeve për autobus do të përmirësonte cilësinë e transportit publik dhe njëkohësisht do të rritet edhe siguria në komunikacion.

2. Rregullimi teknik dhe përmirësimi i qarkullimit rrugor

Në këtë fushë kemi për qëllim përmirësimin e qarkullimit në trafik, në njejt kryesore të qytetit dhe përmirësimin e kryqëzimeve ekzistuese me rreth-rrotullime, ndërsa projektet e reja për rregullimin dhe përmirësimin e qarkullimit në komunikacion do t'i planifikojmë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Infrastrukturës.

Gjatë vitit 2023 kemi planifikuar të implementojmë edhe dy projekte të cilat i kemi konsideruar të rëndësishme për sigurinë në trafik:

3. Rregullimi i njejve në trafik

Në kuadër të këtij projekti është paraparë intervenimi në kryqëzime ekzistuese të trafikut të cilat janë të pa-rregullta, meqenëse sipas analizës të disa njejve brenda zonës urbane dhe në disa fshatra është konstatuar se qarkullimi në këto rrugë, konkretisht lëvizja e veturave gjatë kyçeve - shkyçjeve në këto kryqëzime është e vështirësuar dhe paraqet rrezik në trafik. Qëllimi i realizimit i këtij projekti është krijimi i qarkullimit sa më efikas dhe më i sigurt në trafik.

4. Vendosja e shtyllave dinamike dhe statike anti-parking sistem.

Ky projekt është paraparë të realizohet në pjesën urbane të qytetit, konkretisht në sheshin e qytetit të Ferizajt, pikërisht në çdo hyrje në sheshe të kufizohet me shtylla anti-parking sistem, me qëllim të parandalimit të lëvizjes së veturave të pa autorizuara. Qëllimi i realizimit i këtij projekti është siguria e përgjithshme e qytetarëve.

5. Mirëmbajtja e rrugëve me shenja të trafikut.

Në këtë pik është paraparë mirëmbajtja e rrugëve të qytetit (kryesore, rrjedhëse, dhe lokale) dhe fshatrave me sinjalizim horizontal dhe vertikal, pikërisht vendosja e shenjave të lajmërimit, rrezikut, ndalimit dhe udhëtregues të drejtimit në rrugët e qytetit dhe fshatrave si dhe shënimi i rrugëve me shenja horizontale (vija gjatësore e aksit, vija gjatësore e parkingjeve, ishujt e ndryshëm, vendkalimet e këmbësorëve, punimi i shigjetave dhe logove tjera), gjithashtu është paraparë edhe vazhdimi i vendosjes së shenjave ndriçuese monitor digjital si dhe shenja vertikale të trafikut të cilat duhet të jenë digjitale.

6. Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja te veçanta

Objektivë tjetër kryesore e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë është përmirësimi i kushteve të lëvizshmërisë dhe ofrimi i shërbimit të transportit publik të sigurt për personat me aftësi të kufizuara. Për vitin 2023 është paraparë që në rrugët e qytetit dhe fshatrave, pikërisht para vendkalimeve të shënuara të këmbësorëve të bëhet ulja e skajorëve deri në nivelin e shtresës së asfaltit (projekt kapital).

7. Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të qytetit

Gjithashtu gjatë vitit 2023 në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe Stacionit Policor Ferizaj kemi planifikuar zgjerimin e rrjetit në vendosjen e kamerave të reja dhe mirëmbajtjen e kamerave ekzistuese të Qytetit, ky projekt është shumë i rëndësishëm për sigurinë e përgjithshme të qytetit.

8. Plotësimi i akteve ligjore.

- Hartimi dhe miratimi i planit për tërheqjeje të mjeteve me merimangë, sipas ligjit mbi sigurinë në Komunikacion dhe udhëzimit administrativë të PK-së.
- Hartimi dhe miratimi i Planit për Organizimin e Transportit Publik të Udhëtarëve dhe Mallrave, në pajtueshmëri me Ligjin e Transportit Rrugor Nr. 04/L-179.
- Hartimi dhe miratimi i Rregullores për parkingjet publike dhe private
- Hartimi dhe miratimi i planit të komunës për Mobilitet (DRAFT)
- Hartimi dhe miratimi i planit për TAXI

Sektori i ndriçimit publik

Ndriçimi publik po shkon duke u shtrirë në të gjitha pjesët e komunës me një ritëm dinamik krahas edhe infrastrukturës tjetër rrugore duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve për rregullimin e ndriçimit publik në hapësirat ku ata banojnë, të cilat janë vazhdimisht në rritje.

Por ekzistojnë ende rrugë dhe hapësira të banuara dhe të frekuentuara ndërkohë edhe rrugë të reja që janë hapur që kanë nevojë për ndriçim. Me qëllim të ekonomizimit të energjisë elektrike që disa vite në rrjetin e ndriçimit publik jemi duke vendosur trupa ndriçues eficient LED të cilët janë poqa ekonomik dhe ekologjik për ambientin.

Për më tepër ne po përpiqemi që të vejmë në zbatim edhe direktivat dhe rekomandimet e Traktatit për Energji nga programi i BE-së për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në objektet publike dhe duke i respektuar këto rekomandime që kanë për qëllim efijencën e shfrytëzimit të energjisë elektrike në mënyrë që të kemi sa më pak nevojë për djegieje të thëngjillit në termocentrale dhe rrjedhimisht edhe më pak emetim të gazrave toksike në atmosferë, në të gjitha instalimet e reja të ndriçimit publik në komunë, jemi duke i aplikuar trupat ndriçues eficient të teknologjisë LED.

- Përveç instalimit në rrugët e reja ne po bëjmë instalimin e këtyre trupave ndriçues edhe në rrugët ku kemi ndriçim ekzistues të tipit më pak eficient siç janë poqët nga Natriumi Në vitin 2023, në kuadër të pozicionit buxhetor për rregullimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik planifikojmë që të bëjmë mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues dhe rregullimin e ndriçimit publik në rrugët ku nuk ka ndriçim publik në bazë të kërkesave të qytetarëve, kërkesa këto që ne i kemi të shumta por që duke i vlerësuar si kërkesa që kanë arsyeshmëri në bazë të nevojës për siguri të lëvizjes së qytetarëve, ne planifikojmë që t'i fusim në listën e punëve e shërbimeve me prioritet në kuadër të DSHPE-së dhe t'i realizojmë kërkesat e tyre.
- Për shkak të kërkesave të shumta aktivitetet për rregullimin e ndriçimit publik në rrugët dhe hapësirat e qytetit dhe fshatrave të komunës nuk kemi mundur t'i kryejmë në tërësi, andaj në vitin 2023 planifikojmë t'i përfundojmë ato (në harmoni me buxhetin e aprovuar)
- Nga buxheti komunal planifikojmë ta rregullojmë ndriçimin publik komplet në rr. Ahmet Kaçiku në të cilën, ndriçimi ekzistues është hequr në tërësi dhe në një pjesë të rrugës "Gursel dhe Bajram Sylejmani" për arsye të zgjerimit të hapësirës së punimeve në rregullimin e hekurudhës që e kanë bërë dhe janë duke e bërë ende "Hekurudhat e Kosovës"

- Siç e kemi bërë traditë edhe në vitin 2023 do të bëjmë dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit
- Komfor buxhetit do të shqyrtohen edhe kërkesat e qytetareve që mund të paraqiten gjatë vitit 2023

Mirëmbajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali druri dhe plastika

Varësisht nga kërkesat dhe nevojat që do të na paraqiten, gjatë vitit 2023 planifikojmë të zhvillojmë aktivitete në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrethojave të oborreve të shkollave, ambulancave dhe ndonjë pronë tjetër komunale ku paraqitet nevoja të bëjmë konstruksione të tilla, ndërtimin e rrjetave mbrojtëse në fushat e futbollit, vendosjen e ulëseve dhe shportave të mbeturinave në trotuare parqe sheshe etj.